



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 843/Prot
4

Tiranë, më 12/11 .2015

V E N D I M

Nr. 46 ,datë 12/11 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Qendra Tregëtare Univers" Sh.p.k., Tiranë,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.187 datë 23.09.2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Qendra Tregëtare Univers" Sh.p.k., me objekt:

- *Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme" i ndryshuar.*
- *Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.*

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara në dosje konstaton se:

Kontrolluesi, kompania "Qendra Tregëtare Univers" SH.P.K., në hyrje të ambienteve ku ai ushtron veprimtarinë e tij, nuk kishte realizuar informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave (CCTV), duke rënë ndesh me nenin 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit:

"Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...etj".

Në ambientet e këtij kontrolluesi nuk u konstatua asnjë tabelë, gjë të cilën e provojnë fotot e marra për këtë qëllim, në hyrje të Qendrës Tregtare.

Një ditë pas ushtrimit të kontrollit administrativ, ambientet e kontrolluesit u pajisën me tabelat e informimit.

Kontrolluesi, kompania “Qendra Tregtare Univers” SH.P.K., nuk ka marrë masa për realizimin e detyrimit për njoftim, qoftë në rrugë manuale apo dhe atë elektronike, duke rënë ndesh, me nenin 21 dhe 22 (Përgjegjësia për të njoftuar), të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas të cilit:

“1-Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.”

Për gjetjet e konstatuara është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 07.10.2015, si dhe në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 23.10.2015 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ. Në këtë seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i kontrolluesit dhe u administruan pretendimet me shkrim.

Kontrolluesi “Qendra Tregtare Univers”, paraqiti pretendimet se e kishin përmbushur detyrimin për njoftim, pasi paraqitën dy formularë njoftimi të mëparshëm të cilët datojnë:

1- Datë 05.09.2014, emër të subjektit fizik: Mane TCI SH.P.K., NIPT - K22203004A;

2- Datë 13.11.2014, emër të subjektit fizik: ACREM SH.P.K., NIPT - K220801400;

Formulari i Njoftimit i kryer, po në datën e kontrollit administrativ, 09.10.2015, ka emër të subjektit fizik; Qendra Tregtare Univers SH.P.K., NIPT – L42411002K, rregjistruar në QKR, më datë 11.12.2014. Pra, ky kontrollues ka qënë pamundësisht i monitorueshëm nga kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi formulari i njoftimit të kontrolluesit, u realizua si dhe më lart theksuam, në datë 09.10.2015, duke ndryshuar totalisht gjeneralitetet identifikuese: NIPT-in dhe emrin tregëtar.

Pretendimet e paraqitura nuk justifikojnë kontrolluesin, pasi Zyra e Komisionerit kur monitoron veprimtarinë e kontrolluesve nëpërmjet regjistrin online të njoftimeve, e ka të pamundur të kryejë këtë veprim, nëse kontrolluesit kryejnë ndryshime thelbësore të natyrës juridike tregëtare, si në këtë rast, të NIPT-it dhe emrit tregëtar. Ky rast është serioz, pasi kontrolluesi gjendet në kushtet e moszbatimit të detyrimit ligjor të neneve 18, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në këto pretendime kontrolluesi pranon që konstatimet e grupit të kontrollit janë të sakta, si dhe raporton për marrjen e masave lidhur me plotësimin detyrimeve ligjore të konstatuara nga kontrolli administrativ i kryer pranë tyre.

Komisioneri, duke shqyrtuar provat e depozituara nga kontrolluesi, veçanërisht rregulloren e brendshme të tij, “Rregullore e Brendshme e Punëmarrësit & Mbrojtja e të Dhënave Personale”, shpreh rezerva, për sa i përket kreut IV, “Siguria e të Dhënave Personale”, pasi, nëse do të ishin zbatuar ato masa të shkruara, edhe pse jo të detajuara, kontrolluesi nuk do të gjendej në kushtet e

shkelësit të neneve 18&21 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Si përfundim konkludoj se, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ, në kuptim të nenit 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbën “**kundërvajtje administrative**” dhe sanksionohet me gjobë.

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, pasi lidhet me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, për gjithë fluksin e madh të qytetarëve-klientë që frekuentojnë këtë qëndër, me detyrimet që i dalin kontrolluesit nga zbatueshmëria e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 39/2, në të cilin parashikohet se: “*Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni*”, faktin që kontrolluesi ka qenë serioz dhe bashkëpunues gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ dhe ka marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 29, 30, 31, paragrafi 1, gërma a/1, 32, 39/1, paragrafi “b”, 39/1, paragrafi “d”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenit 72/3 të Ligjit Nr.49/2012, datë 11.05.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Qendra Tregtare Univers” SH.P.K., me gjobë në vlerën 40. 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit “Qendra Tregtare Univers” SH.P.K., me gjobë në vlerën 40. 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 21** të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Zbatimin e Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme” i ndryshuar.

-Të hartohet një rregullore të veçantë e detajuar, mbi përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet sistemit të kamerave vëzhguese – CCTV.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më datë 12.11.2015.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
